

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti i Përgjithshëm -

PADITËSIT:

1. **Astrit Istrefi**, me numër personal [REDAKTUAR], me vendbanim në adresën rruga [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë;

2. **Burim Ejupi**, me numër personal [REDAKTUAR], me vendbanim në adresën [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë;

3. **Visar Azemi**, me numër personal [REDAKTUAR], me vendbanim në adresën [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë;

(tutje referuar si "Paditësit"), në kapacitetin e tyre si **Themelues dhe Anëtarë të Bordit të Drejtorëve të FONDACIONIT SHTËPIA E SHOQËRISË CIVILE – CSH**, me numër të regjistrimit të OJQ-së **5200400-**

4. Paditësit përfaqësohen sipas Autorizimit nga: Avokat Kushtrim Palushi, Fisnik Salihu dhe Visar Ramaj, me seli të zyrës në adresën Rruga Major Mehmet Bushi, H-6/5, Prishtinë.

TË PADITUR:

1. **Dajana Berisha**, me numër personal [REDAKTUAR], me vendbanim në adresën rruga [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë, me numër telefoni +383 (0) [REDAKTUAR];

2. **Jeta Xharra**, me numër personal [REDAKTUAR], me vendbanim në adresën rruga [REDAKTUAR], Prishtinë, Kosovë, me numër të telefonit +383 (0) [REDAKTUAR];

3. **Fondacioni Shtëpia e Shoqërisë Civile - CSH**, me numër të regjistrimit të OJQ-së **5200400-4**, me seli në adresën rruga **Pashko Vasa, Nr. 1, lagja Pejton, 10000 Prishtinë, Kosovë**.

(tutje referuar individualisht si "e/i Padituri" ose bashkërisht si "të Paditurit").

PADI VËRTETIMI

dhe

PROPOZIM PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURISË

I. HYRJE, OBJEKTI I ÇËSHTJES DHE FAKTET E RASTIT

Kjo Padi Vërtetimi për Lirinë e Asociimit së bashku me Propozimin për Caktimin e Masës së Sigurisë parashtrohet me respekt në përputhje me nenin 254 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (tutje referuar si, "LPK") dhe nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare (tutje referuar si, "Ligji për OJQ"). Gjithashtu, kjo Padi parashtrohet për shkak se Departamenti për Organizatat Joqeveritare (tutje referuar si "DOJQ") në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike përmes akteve të tij ka udhëzuar Padi të tjetër që t'i drejtohen Gjykatës konform nenit 33 të Ligjit për OJQ për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme në mes të anëtarëve të OJQ-së, Fondacioni Shtëpia e Shoqërisë Civile (tutje referuar si, "Fondacioni").

Objekti i çështjes sipas kësaj Padi Vërtetimi është vërtetimi i faktit se Vendimet e marra me datën 05 gusht 2019 nga ana e dy të Paditurave për emërimin e një përbërje tjetër të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit pa pjesëmarrjen e Paditësve si Themelues dhe Anëtar të Bordit në mbledhjen e thirrur është në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Fondacionit dhe Ligjit për Lirinë e Asociimit.

Po ashtu, me këtë Padi Vërtetimi kërkohet të Anuloohen Vendimet kundërstatore dhe të kundërligjshme të datës 05 gusht 2019 të marra nga të Paditurat. Më tutje, me këtë Padi Vërtetimi kërkohet të vërtetohet fakti se Paditësit janë anëtar legjitim të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Përfundimisht, me Propozimin për Caktimin e Masës së Sigurisë propozohet të caktohet masa e sigurisë, përkatësisht t'ju ndalohen kryerja e një sërë veprimesh deri në vendosjen përfundimtare sipas kësaj Padi.

Fondacioni është themeluar dhe regjistruar me datë 29 maj 2017, përmes dorëzimit të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Listës së Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve pranë Departamentit për OJQ. Këto dokumente kanë përcaktuar në mes tjerash: A) Themeluesit e Fondacionit; B) Bordin e Drejtorëve të Fondacionit; dhe C) Përfaqësuesin e Autorizuar të Fondacionit. Fondacioni ka pesë (5) themelues, të cilët njëherësh – me rastin e themelimit të Fondacionit – janë emëruar edhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, në përbërje të:

1. Burim Ejupi;
2. Visar Azemi;
3. Astrit Istrefi;
4. Jeta Xharra;
5. Dajana Berisha.

Prova Nr. 2: Çertifikata e Regjistrimit të Fondacionit;

Prova Nr. 3: Statuti, Akti i Themelimit dhe Lista e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Qëllimet e themelimit të Fondacionit kanë qenë ndër të tjera, përmirësimi i frymës së bashkëpunimit profesional, sigurimi i qëndrueshmërisë së shoqërisë civile, ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile, si dhe zhvillimi i bashkëpunimit në mes të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Për t'i arritur këto qëllime, Themeluesit e Fondacionit, njëherësh edhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, kanë vendosur që Fondacioni të blejë një pronë të paluajtshme për ta shfrytëzuar si hapësirë për realizimin e qëllimeve të Fondacionit. Pas një numri të madh takimesh, këtë ide e ka përkrahur edhe donatori Rockerfeller Brothers Fund, fondacion ndërkombëtar me seli në New York, Sh.B.A., e cila e ka përkrahur këtë nismë të Fondacionit me shumën prej rreth 1,000,000.00 Euro (me fjalë: një milion Euro).

E Paditura Dajana Berisha ishte caktuar si Përfaqësuese e Autorizuar e Fondacionit nga ana e Bordit të Drejtorëve me rastin e regjistrimit të Fondacionit, përmes Aktit të Themelimit dhe në përputhje me procedurat e parapara në Statutin e Fondacionit. Në kapacitetin e saj si Përfaqësuese e Autorizuar, e Paditura Dajana Berisha i është përgjigjur Bordit të Drejtorëve dhe ka marrë instruksione dhe autorizime për punën e saj gjithashtu nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit.

Ndërmjet datës 11 qershor 2019 dhe 20 gusht 2019, anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, Paditësit Burim Ejupi dhe Visar Azemi, kanë dërguar katër shkresa përmes e-mailit tek të gjithë anëtarët e tjerë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, me kërkesë për të mbajtur mbledhjen e rregullt të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit dhe për të diskutuar rreth progresit në lidhje me ndërtimin e objektit të destinuar për Fondacionin, dhe duke qenë se një mbledhje e tillë nuk ishte mbajtur për pothuajse një vit. Kërkesat për takim të Bordit të Drejtorëve ishin dërguar përmes emailit tek të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, pra tek znj. Dajana Berisha, znj. Jeta Xharra, z. Astrit Istrefi, z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi. Dy anëtarët znj. Dajana Berisha dhe znj. Jeta Xharra nuk u përgjigjen në e-mailat dhe korrespondencat e anëtarëve të tjerë të Bordit.

Me datë 05 gusht 2019, e Paditura Dajana Berisha, në kapacitetin si Themeluese dhe Përfaqësuese e Autorizuar e Fondacionit, mbanë një mbledhje të parregullt, kundërstatore dhe të paligjshme të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, ku nga pesë (5) anëtarët e Bordit të Drejtorëve, e fton në mbledhje vetëm të Paditurën tjetër, Jeta Xharra. Ndërkaq nuk ju dërgon ftesë tre anëtarëve të tjerë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit: përkatësisht Paditësve Astrit Istrefi, Burim Ejupi dhe Visar Azemi. Paditësit nuk kanë pasur fare dijeni për mbledhjen e mbajtur, agjendën e saj apo vendimet që janë miratuar aty.

Në takimin e datës 05 gusht 2019, e Paditura Dajana Berisha, duke shpërfillur procedurat e parashikuara me Statut të Fondacionit, pa i ftuar të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, bën emërimin e kundërligjshëm të tre (3) anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, më saktësisht z. Faik Ispahiu, z. Fatos Lajçi dhe z. Luan Dalipi. Këta të fundit më pas emërojnë edhe dy anëtarë tjerë të Bordit të Fondacionit, të Paditurat Jeta Xharra dhe Dajana Berisha. Këto vendime, të kundërligjshme e të nxjerra në kundërshtim me statutin e Fondacionit dorëzohen pranë Departamentit për OJQ nga ana e të Paditurës Dajana Berisha për regjistrim në dosjen e Fondacionit dhe pasqyrimin e tyre në regjistrin publik të OJQ-ve. Në këtë rast, e Paditura Dajana Berisha, ka pretenduar në mënyrë të pabazuar se po emëron përbërjen e parë

të Bordit të Drejtorëve, ani pse përbërja e parë e Bordit të Drejtorëve vetëm se ekzistonte, e që ishin pesë (5) themeluesit, respektivisht znj. Dajana Berisha, znj. Jeta Xharra, z. Astrit Istrefi, z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi. Së paku tre pjesëmarrës në takimin e datës 05 gusht 2019, respektivisht të Paditurat Dajana Berisha dhe Jeta Xharra si dhe Koordinatorin e Fondacionit z. Haki Abazi e kanë ditur se Fondacioni veçse kishte bord dhe që mbledhja nuk mund të mbahej për shkak të mungesës së kuorumit si pasojë e mos ftesës dhe mos prezencës së tre (3) themeluesve dhe anëtarëve tjerë të bordit këtu Paditësit.

Departamenti për OJQ i ka pranuar ndryshimet e bëra përmes Vendimeve të datës 05 gusht 2019 duke i përditësuar të dhënat në regjistrin e OJQ-ve. Këtë akt, Departamenti për OJQ e arsyeton duke thënë se ata nuk e bëjnë verifikimin e saktësisë dhe bazës ligjore për ndryshime të tilla, përkundër se ndryshimet ishin qartësisht të kundërligjshme dhe në kundërshtim me faktet dhe dosjen të cilën veçse e kishte në dispozicion Departamenti për OJQ që nga çasti i regjistrimit.

Prova Nr. 4: Procesverbali i takimit të datës 05 gusht 2019.

Me datë 30 gusht 2019, Bordi i Drejtorëve të Fondacionit, në përbërje të anëtarëve, z. Burim Ejupi, z. Visar Azemi, dhe z. Astrit Istrefi e mbajnë mbledhjen e jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Në këtë takim, Bordi i Drejtorëve unanimisht merr vendim që në përputhje me dispozitat e Statutit të shkarkojë të Paditurën Dajana Berisha nga detyra e Përfaqësueses së Autorizuar të Fondacionit dhe të emërojë znj. Learta Hollaj si Përfaqësuese të Autorizuar. Vendimet e kësaj mbledhje bashkë me procesverbalin e mbledhjes, Bordi i Drejtorëve të Fondacionit ia kanë kumtuar në mënyrë të rregullt përmes postës elektronike të Paditurave Dajana Berisha dhe Jeta Xharra më datë 4 shtator 2019. Asnjëra nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit nuk i është përgjigjur emailit me të cilin janë njoftuar për vendimet e marra nga Bordi i Drejtorëve dhe nuk e kanë paraqitur asnjë kundërshtim në lidhje me këto vendime.

Provë 5: E-mail dhe komunikimi i ftesës dhe Vendimet e Bordit të Drejtorëve.

Me datë 02 shtator 2019, Fondacioni i drejtohet Departamentit për OJQ, me Kërkesë të nënshkruar nga tre anëtarët e Bordit të Drejtorëve, z. Astrit Istrefi, z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi, për pranimin dhe regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e OJQ-ve në përputhje me Vendimet e marra me datën 30 gusht 2019. Bashkëngjitur me këtë kërkesë është dërguar edhe Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve dhe Vendimet e marra në këtë mbledhje.

Me datë 23 shtator 2019, Departamenti për OJQ njofton anëtarët e Bordit të Drejtorëve, z. Astrit Istrefi, z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi, me Aktin Administrativ me Numër Ref. 06-145/2019 i datës 23 shtator 2019, përmes të cilit i njofton **për herë të parë** për ndryshimet e bëra të datës 05 gusht 2019 të cilat i ka regjistruar pa verifikuar nëse ndryshimet janë bërë në përputhje me Statutin e Fondacionit dhe Ligjin për OJQ si dhe refuzon kërkesën e datës 02 shtator 2019 për regjistrimin e ndryshimeve të aprovuara me datën 30 gusht 2019. Departamenti për OJQ rekomandoi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të brendshme në mes të themeluesve në mënyrë miqësore apo përmes gjykatës.

Pas Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruar nga Paditësit, me datë 11 nëntor 2019, Departamenti për OJQ konfirmoi qëndrimin e këtij Departamenti që për mosmarrëveshje në lidhje me Fondacionin, Paditësit duhet t'i drejtohen gjykatës.

II. BAZA JURIDIKE E KËRKESË-PADISË

Baza juridike për këtë Padi Vërtetimi si dhe për Propozimin për Caktimin e Masës së Sigurisë, buron nga LPK dhe Ligji për OJQ si vijon:

Ligji për Procedurën Kontestimore

Neni 252

Gjykimi i një çështje në gjykatë fillon me paraqitjen e kërkesëpadisë me shkrim (padi detyrimi, vërtetimi dhe ndryshimi)

Neni 254

254.1 Paditësi mund të kërkojë me padi që gjykata vetëm të konstatojë ekzistimin, përkatësisht mosekzistimin, e një të drejte apo të një raporti juridik, ose vërtetësinë, gjegjësisht mos vërtetësinë e ndonjë dokumenti.

254.2 Padia e këtillë mund të ngrihet kur kjo është përcaktuar me dispozita të posaçme, apo kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë ekzistimin apo mosekzistimin e ndonjë të drejte apo të raportit juridik, ose vërtetësinë, respektivisht mos vërtetësinë e ndonjë dokumenti para se të jetë bërë e kërkueshme kërkesa për pretim nga raporti i njëjtë.

Neni 296

296.1 Për vendosje mbi propozimin për sigurim të paraqitur para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore, si dhe gjatë procedurës së tillë, është kompetente gjykata që vepron sipas padisë. Vendimin mbi masën e sigurimit e jep gjykata që vepron në shkallë të parë, kurse gjykata më e lartë atëherë kur propozimi për marrjen e saj është paraqitur pas dërgimit të dosjes së lëndës sipas ankesës në këtë gjykatë.

Neni 297

297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Ligji për OJQ

Neni 5 – Trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo person ushtron lirinë e asociimit në mënyrë të barabartë.

Neni 17 – Fondacioni

1. Fondacioni është organizatë pa anëtarësi, i themeluar për menaxhimin e pronave dhe pasurive, për realizimin e qëllimeve të ligjshme për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë.

2. Fondacioni themelohet nga një (1) apo më shumë persona.

3. Fondacioni themelohet me kapital fillestar i cili duhet të jetë jo më pak se njëmijë euro (1,000 €), me testament, apo me lënie të trashëgimisë.

Neni 20 – Statuti i OJQ-së

1. Rregullimi i hollësishëm i çështjeve të organizimit, të funksionimit dhe të veprimtarisë së OJQ-së, parashikohet me statutin e saj.

[...]

8. Rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ – së, duhet të jenë në pajtim me parimet demokratike.

9. OJQ zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe me këtë ligj.

[...]

Neni 21 – Asociimi i Personave Juridik

Personat juridik, duke përfshirë edhe OJQ-të, mund të themelojnë shoqata, fondacione apo institute për të përparuar qëllimin e tyre të ligjshëm, qoftë për përfitim publik apo të ndërsjellë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 31 Udhëheqja e brendshme e OJQ-së

1. Organi më i lartë drejtues i shoqatës është Kuvendi i anëtarëve, i cili përbëhet nga të gjithë anëtarët e shoqatës.

2. Organi më i lartë drejtues i një fondacioni apo instituti është Bordi drejtues, i cili përbëhet nga të paktën tre (3) anëtarë.

3. Organi më i lartë drejtues mbledhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

4. Organi më i lartë drejtues ka përgjegjësi të plotë për çështje të politikave dhe financave të organizatës dhe takohet të paktën një herë në vit, ku shqyrton dhe miraton raportin financiar dhe

të veprimtarisë së organizatës për vitin e paraprak, si dhe planin e veprimtarisë së organizatës për vitin vijues.

[...]

Neni 33 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve, ndërmjet tyre dhe organeve të larta drejtuese apo me organet e ndërmjetme dhe ose ndërmjet tyre dhe të punësuarve zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e brendshme të OJQ-së, në të kundërt çështja zgjidhet nga gjykata.

III. ARSYETIMI I KËRKESË-PADISË

A. Veprimet e të Paditurave janë në kundërshtim me Statutin e Fondacionit dhe Ligjin për OJQ

Fondacioni ka caktuar të Paditurën Dajana Berisha si Përfaqësuese e Autorizuar e Fondacionit nga ana e Bordit të Drejtorëve me rastin e regjistrimit të Fondacionit, përmes Aktit të Themelimit dhe në përputhje me procedurat e parapara në Statutin e Fondacionit. Në kapacitetin e saj si Përfaqësuese e Autorizuar, e Paditura Dajana Berisha i është përgjigjur Bordit të Drejtorëve dhe ka marrë instruksione dhe autorizime për punën e saj gjithashtu nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj janë të përcaktuara me Statutin e Fondacionit.

Me datë 05 gusht 2019, e Paditura Dajana Berisha ka mbajtur një mbledhje të parregullt, kundërstatutore dhe të paligjshme të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, ku nga pesë (5) anëtarët e Bordit të Drejtorëve e ka ftuar në mbledhje vetëm të Paditurën Jeta Xharra, ndërkaq nuk ka ftuar edhe tre anëtarët tjerë, Paditësit z. Astrit Istrefi, z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi. Paditësit nuk kanë pasur fare dijeni për mbledhjen e thirrur dhe të mbajtur, agjendën e saj apo vendimet e miratuara aty. Në mbledhjen e parregullt të datës 05 gusht 2019, të Paditurat kanë miratuar një sërë vendimesh. Vendimi i parë dhe i kundërligjshëm ka të bëjë me emërimin e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, përkatësisht z. Faik Ispahiu, z. Fatos Lajçi dhe z. Luan Dalipi, nën pretendimin e emërimit të përbërjes së parë të Bordit të Drejtorëve nga ana e të Paditurave. Vendimi i dytë i kundërligjshëm ka të bëjë me emërimin e dy të paditurave, znj. Dajana Berisha dhe znj. Jeta Xharra si anëtare shtesë të Bordit të Drejtorëve nën pretendimin e njëjtë se po emëroheshin si pjesë e përbërjes së parë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit.

Mbledhja e thirrur dhe e mbajtur me datë 05 gusht 2019 si dhe vendimet e miratuara aty nga të Paditurat janë kundërstatutore dhe të kundërligjshme për arsyet në vijim: 1) Mbledhja është thirrur në mënyrë të parregullt dhe është mbajtur në mungesë të kuorumit të nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes të përcaktuar me Statutin e Fondacionit; 2) Bordi i Drejtorëve të Fondacionit veçse ishte emëruar me rastin e regjistrimit të Fondacionit; 3) Themeluesja dhe Përfaqësuesja e Autorizuar e Fondacionit znj. Dajana Berisha nuk ka pasur autorizim për emërimin e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

1) Mbledhja e datës 05 gusht 2019 është e kundërligjshme për shkak se është thirrur në mënyrë të parregullt dhe është mbajtur në mungesë të kuorumit të nevojshëm

Mbledhja e datës 05 gusht 2019 është thirrur në kundërshtim me nenin 5, paragrafi 3 të Statutit të Fondacionit. Neni 5, paragrafi 3 i Statutit të Fondacionit thekson se **“Lajmërimi me shkrim për MPV dhe/ose MPJ, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për mbledhjen do t’u shpërndahet të gjithë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.”** E Paditura Dajana Berisha nuk ju ka dërguar Lajmërim me shkrim tre (3) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, në këtë rast Paditësve, z. Astrit Istrefi; z. Burim Ejupi dhe z. Visar Azemi, për mbajtjen e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve apo rendin e ditës për mbledhjen. Si rezultat i kësaj Paditësit nuk kanë pasur dijeni për mbledhjen e thirrur për datën 05 gusht 2019 dhe nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë aty dhe të shprehin mendimet e tyre dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre si themelus dhe anëtar të bordit të drejtorëve të Fondacionit.

E Paditura Jeta Xharra, ka marrë pjesë në mbledhjen e thirrur nga e Paditura Dajana Berisha, ndërkaq asnjëherë nuk ka shprehur kundërshtimin e saj për marrjen pjesë në një mbledhje ku nuk kanë qenë të ftuar tre (3) nga anëtarët e bordit të ligjshëm të drejtorëve të Fondacionit. Po ashtu, nga procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 05 gusht 2019 dëshmohet se e Paditura Jeta Xharra asnjëherë nuk ka pyetur se a janë ftuar anëtarët e bordit të drejtorëve në mbledhje. Madje, ajo e ka nënshkruar listën e anëtarëve të Z. Luan Dalipi, Z. Faik Ispahiu dhe Z. Fatos Lajçi, duke qenë e vetëdijshme gjatë tërë kohës se po vepron në kundërshtim me Statutin e Fondacionit dhe në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Përveç që mbledhja është thirrur në mënyrë të parregullt, e njëjta është mbajtur edhe në mungesë të kuorumit. Neni 5, paragrafi 4 i Statutit të Fondacionit thekson se **“për mbajtjen e mbledhjes është e nevojshme pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Nëse ky kuorum nuk arrihet në tentimin e parë, takimi do të shtyhet për një ditë të pacaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t’u dërgohet të gjithë anëtarëve.”** Në mbledhjen e mbajtur me datën 05 gusht 2019, kanë marrë pjesë vetëm dy (2) nga pesë (5) anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, pra më pak se gjysma e anëtarëve. Si rrjedhojë e kësaj nuk ka pasur kuorum për mbajtjen e mbledhjes dhe e njëjta është dashur të shtyhet për një ditë të pacaktuar më vonë dhe lajmërimi të ju dërgohet të gjithë anëtarëve, pra edhe tre (3) anëtarëve të tjerë, këtu Paditësve, që nuk ishin ftuar në radhë të parë.

Prova Nr. 4: Procesverbali i takimit të datës 05 gusht 2019.

Përkundër mungesës së kuorumit të nevojshëm prej më shumë se gjysmës së anëtarëve, të Paditurat kanë mbajtur mbledhjen dhe kanë miratuar Vendime të kundërligjshme të cilat janë dorëzuar dhe pranuar edhe nga Departamenti për OJQ.

2) Përbërja e parë e Bordit të Drejtorëve është emëruar me rastin e regjistrimit të Fondacionit dhe Fondacioni veçse ka pasur Bord të Drejtorëve

Me rastin e regjistrimit të Fondacionit me datë 19 qershor 2017, është emëruar, nga ana e të gjithë themeluesve, përbërja e parë e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit prej pesë (5) anëtarëve në vijim: Burim Ejupi, Visar Azemi, Astrit Istrefi, Jeta Xharra dhe Dajana Berisha. Kjo vërtetohet përmes Statutit, Aktit të Themelimit dhe Listës së Bordit Drejtorëve të dorëzuar në Departamentin për OJQ me rastin e regjistrimit.

Lista e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve është një prej parakushteve dhe dokumenteve kryesore që kërkohen për regjistrim të Fondacionit sipas nenit 4, paragrafi 3, pika 8 e Udhëzimit Administrativ (Nr.02-2014) për Regjistrim dhe Funkcionim të Organizatave Jo-Qeveritare. Me fjalë të tjera, Fondacioni nuk do të mund të regjistrohej pa pasur Bord të Drejtorëve. Prandaj, pretendimi i të Paditurave i shfaqur në mbledhjen e parregullt të datës 05 gusht 2019, se gjoja Fondacioni nuk ka pasur Bord të Drejtorëve është absurd, i pambështetur në prova dhe i papranueshëm.

Fakti se Fondacioni ka pasur Bord të Drejtorëve prej pesë (5) anëtarëve, dëshmohet krahas dokumenteve të themelimit, edhe përmes komunikimeve përmes e-mailit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Kështu, pas mbajtjes së mbledhjes përmes Skype me datën 2 dhjetor 2017, Bordi i Drejtorëve të Fondacionit në përputhje me kompetencat e parashikuara me Statut, në pikën 1 të e-mailit të dërguar nga e Paditura Dajana Berisha, Procesverbalit është pajtuar "...për ofertën e propozuar prej Dukagjini Invest (hapësirën prej 994.21 m²; plus 9 vend parkingje; koston në shumën 930.000 euro.)"; ndërsa në pikën 3 të Procesverbalit theksohet se "Bordi i CSH pajtohet për nënshkrimin e kontratës në 11 Dhjetor 2017".

Prova Nr. 7: E-mail nga e Paditura Dajana Berisha drejtuar anëtarëve të Bordit të Fondacionit i datës 2 dhjetor 2017.

Kjo provë dëshmon se në bazë të aprovimit shprehimor me shkrim nga ana e Bordit të Drejtorëve të datës 02 dhjetor 2017, me datën 12 dhjetor 2017, Përfaqësuesja e Autorizuar e Fondacionit, e Paditura Dajana Berisha ka nënshkruar Kontratën mbi Bashkimin e Mjeteve për Blerjen e Banesës në Procesin Ndërtimor me Shitësin, kompaninë Dukagjini Invest. Fondacioni, sipas nenit 31, paragrafi 2 të Ligjit për OJQ dhe nenit 4, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Fondacionit, ka si organ më të lartë drejtues Bordin e Drejtorëve i cili ka përgjegjësi të plotë për çështje të politikave dhe financave të organizatës. Këtë kompetencë sipas nenit 31, paragrafi 5, pika 1 të Ligjit për OJQ, Bordi nuk mund ta delegojë te asnjë organ vartës i tij. Andaj vetë kontrata e nënshkruar dëshmon ekzistencën e Bordit të Drejtorëve për shkak se do të ishte e pamundur ligjërisht që Përfaqësuesja e Autorizuar e Fondacionit, këtu e Paditura Dajana Berisha të marrë vendim, në emër të Fondacionit për të lidhur Kontratën mbi Bashkimin e Mjeteve për Blerjen e Banesës në Procesin Ndërtimor, pa e pasur lejen paraprake për lidhjen e një kontrate të tillë nga Bordi i Drejtorëve të Fondacionit.

Ndryshimi i përbërjes së Bordit të Drejtorëve, në përputhje me Statutin dhe Ligjin për OJQ, ka mundur të bëhet vetëm nga ana e Bordit të Drejtorëve ekzistues, përmes procedurës së votimit duke i përfillur rregullat e Statutit dhe Ligjit për OJQ. Çfarëdo pretendimi se Fondacioni nuk ka

pasur fare Bord të Drejtorëve është deklarata e pavërtetë dhe është në kundërshtim me çfarë do interpretimi ligjor të kësaj çështje.

Bordi i Drejtorëve të Fondacionit është përbërë nga pesë (5) Themeluesit e Fondacionit, respektivisht nga: Astrit Istefi, Burim Ejupi, Dajana Berisha, Jeta Xharra, dhe Visar Azemi. Kjo përbërje e Bordit të Drejtorëve bazuar në nenin 4 të Statutit të Fondacionit është zgjedhur **me një mandat prej pesë (5) vitesh**. Më tutje, bazuar në nenin 4, paragrafi 8 të Statutit të Fondacionit, mandati i anëtarëve Astrit Istefi, Burim Ejupi dhe Visar Azemi të Bordit të Drejtorëve ka mundur të përfundojë para kohe vetëm në rast të shkarkimit nga vetë Bordi i Drejtorëve. Emërimi i anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve ka mundur të bëhet vetëm pas përfundimit të mandatit të anëtarëve ekzistues të Bordit të Drejtorëve dhe vetëm pas miratimit të anëtarëve të rinj të bordit pas propozimit dhe zgjedhjes me shumicë votash të anëtarëve prezent të Bordit ekzistues të Drejtorëve, sipas nenit 4, paragrafi 6 të Statutit të Fondacionit.

Përderisa Fondacioni ka pasur Bord të Drejtorëve valid dhe të kompletuar, nuk ka mundur të emërohej një përbërje tjetër apo e re e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Si përfundim, në këtë pikë, shkeljet e dukshme të Statutit të Fondacionit dhe Ligjit për OJQ nga ana e të Paditurave znj. Dajana Berisha dhe Jeta Xharra paraqet shkelje dhe cenim të interesave juridike të Paditësve si themelues dhe anëtar të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit.

3) Themeluesja dhe Përfaqësuesja e Autorizuar e Fondacionit znj. Dajana Berisha nuk ka pasur autorizim për emërimin e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve

Nga Procesverbali i mbledhjes së paligjshme të datës 05 gusht 2019, rezulton se e Paditura znj. Dajana Berisha ka pretenduar se në cilësi të Përfaqësueses e Autorizuar e Fondacionit dhe Themelueses së Fondacionit, e njëjta ka të drejtën – krejt e vetme –për emërimin e të tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, të cilët edhe i ka emëruar. Të Paditurat, dhe në veçanti e Paditura Dajana Berisha ka bërë dy shkelje të Statutit të Fondacionit me këtë rast. Shkelja e parë ka të bëjë me tejkalimin e kompetencave si Përfaqësuese e Autorizuar e Fondacionit, dhe shkelja e dytë ka të bëjë me aplikimin dhe interpretimin e gabuar të dispozitave të Statutit të Fondacionit.

Në cilësi të Përfaqësueses e Autorizuar të Fondacionit, e Paditura Dajana Berisha nuk ka pasur autorizim që të propozojë aq më pak të emërojë në mënyrë të kundërligjshme tre anëtarët e Bordit të Drejtorëve, përkatësisht z. Faik Ispahiu, z. Fatos Lajçi dhe z. Luan Dalipi. Sikurse është elaboruar më lartë, kompetenca për emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve është kompetencë ekskluzive dhe e rezervuar e Bordit të Drejtorëve të Fondacionit.

E Paditura Dajana Berisha po ashtu aplikon dhe interpreton gabimisht dispozitën e nenit 4, paragrafi 1 të Statutit të Fondacionit i cili thekson si vijon, **“Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Përbërja e parë e Bordit të Drejtorëve emërohet nga themeluesit.”** Edhe sikur Fondacioni të mos kishte fare Bord të Drejtorëve dhe emërimi i përbërjes së parë të tij duhet të ketë qenë pjesë e rendit të ditës të mbledhjes së datës 05 gusht 2019, e Paditura Dajana Berisha nuk ka pasur të drejtë që e vetme të emërojë tre anëtarët e Bordit të Drejtorëve, përkatësisht z. Faik Ispahiu, z. Fatos Lajçi dhe z. Luan Dalipi. Neni 4, paragrafi 1 i

Statutit të Fondacionit, këtë të drejtë ia njuh të gjithë themeluesve të Fondacionit, sepse shprehet në shumës me fjalën “themeluesit” dhe jo në njëjës p.sh., themeluesja, një themelues, apo të ngjashme. Emërimi i tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve vetëm nga një themelues është tërësisht i kundërligjshëm në çfarëdo rrethane. Ngjashëm, as dy (2) themelues nuk mund të emërojnë përbërjen e parë të Bordit të Drejtorëve, duke përjashtuar tre (3) themelues, kjo për faktin se nevojitet vota e shumicës së themeluesve, që në rastin e Fondacionit me pesë (5) themelues, shumica do të ishte tre (3) themelues. Prandaj, emërimi i tre (3) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve nga një (1) ose dy (2) themelues është në tërësi i kundërligjshëm.

Sipas nenit 20, paragrafi 8 të Ligjit për OJQ, rregullat dhe procedurat për udhëheqje të brendshme që i përmban statuti i OJQ-së duhet të jenë në pajtim me parimet demokratike. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë interpretim ligjor a statutar që do t’a mundësonte autorizimin ligjor të përfaqësueses së autorizuar ose një themelueseje për ta zgjedhur bordin e drejtorëve të Fondacionit. Për pasojë, veprimet e ndërmarra nga e Paditura Dajana Berisha janë krejtësisht të kundërligjshme dhe në kundërshtim me Statutin e Fondacionit.

Të gjitha këto obligime ligjore kanë qenë të njohura si për të Paditurën Dajana Berisha, ashtu edhe për të Paditurën Jeta Xharra. kjo nga se të dyja kanë qenë anëtare të Bordit fillestar të Drejtorëve të themeluar me rastin e regjistrimit të Fondacionit para Departamentit për OJQ, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.

4) E Paditura znj. Dajana Berisha dhe e Paditura Jeta Xharra kanë vepruar në keqbesim dhe kanë shkelur detyrimin për besnikëri ndaj Fondacionit

Sipas nenit 32, paragrafi 3 i Ligjit për OJQ-të, të gjithë anëtarët e OJQ-ve, obligohen që të tregojnë lojalitet ndaj OJQ-së dhe interesat e saj, si dhe “të ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me mirëbesim dhe me kujdes.”

Të gjitha veprimet e të Paditurave të radhitura më sipër dëshmojnë qartazi veprimin në keqbesim të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si dhe shkeljen e obligimit për besnikëri ndaj organizatës, duke filluar nga 1) Mos-dërgimi i ftesës për mbledhjen e bordit të drejtorëve, 2) Mbajtja e mbledhjes së ashtuquajtur për konstituimin e bordit të drejtorëve pa praninë e tre (3) anëtarëve të bordit të drejtorëve, 3) Emërimi i tre anëtarëve të një bordi të ri duke e shpërfillur përbërjen e bordit të vjetër dhe duke i shpërfilluar procedurat e përcaktuara në statut e në Ligjin për OJQ për emërimin bordit të drejtorëve.

IV. PROPOZIMI PËR CAKTIMIN E MASËS SË SIGURISË

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka kompetencë për të vendosur për caktimin e masës së sigurisë, me propozim të Paditësve, bazuar në Nenin 296, par. 1, të LPK-së, i cili ndër të tjera përcakton:

Për vendosje mbi propozimin për sigurim të paraqitur para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore, si dhe gjatë procedurës së tillë, është kompetente gjykata që vepron sipas padisë. Vendimin mbi masën e sigurimit e jep gjykata që vepron në shkallë të parë, kurse gjykata më e lartë atëherë kur propozimi për marrjen e saj është paraqitur pas dërgimit të dosjes së lëndës sipas ankesës në këtë gjykatë.

Sikurse është përcaktuar me ligj, qëllimi i vendosjes së masës së sigurisë është mbrojtja e të drejtave dhe interesave juridike të propozuesit të masës së sigurisë përmes ndalimit të kundërshtarit të sigurimit që të kryejë veprime të caktuara, apo që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë apo disponojë me pasurinë me qëllim të shmangies së dëmtimit të të drejtave dhe interesave juridike të Padiësve.

Në mënyrë që gjykata të lejojë caktimin e masës së sigurisë, propozuesi i masës së sigurisë duhet të plotësojë dy kushte kryesore të përcaktuara me nenin 297, paragrafi 1, i LPK-së, i cili përcakton si në vijim:

297.1 Masa e sigurimit mund të caktohet:

a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe

b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Mbi këtë bazë, për të ruajtur gjendjen ekzistuese deri në vendimin meritor, Padiësit i propozojnë Gjykatës që në përputhje me nenin 301 të LPK-së, deri në marrjen e vendimit përfundimtar për këtë çështje kontestimore, të caktojë masën e sigurisë e cila përfshin:

- a) Ndalimin e Padiësve, Përfaqësueses së Autorizuar dhe Bordit të Drejtorëve të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile” që të kryejnë aktivitetet në vijim:
 - i) Emërimin e zyrtarëve të rinj të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile;
 - ii) Lidhjen e Kontratave për tjetërsimin e pasurisë se luajtshme apo të paluajtshme të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile;
 - iii) Emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile.

A. Padiësit e kanë bërë të besueshme kërkesën e tyre

Në rastin konkret në mes të Padiësve dhe të Paditurit, plotësohen të dy kushtet e parapara me nenin 297, paragrafi 1, pika a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së propozuar të sigurimit

nga ana e Gjykatës. Gjykata, me rastin e vendosjes për masën e sigurisë duhet të ketë parasysh se Fondacioni është pronar i paluajtshmërisë e cila ka vlerë afër 1,000,000.00 (një milion) Euro.

Paditësit në cilësinë e Themeluesve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve me provat e bashkëngjitura kësaj Padie Vërtetimi, e kanë bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive të tyre që të vërtetohet se të njëjtit janë Anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit dhe që vendimet e marra nga të Paditura me datë 05 gusht 2019 për emërimin e tre (3) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve janë të kundërligjshme. Fakti se Paditësit janë Anëtarë legjitim të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit vërtetohet me provat e bashkëngjitura sikurse janë Certifikata e Regjistrimit të Fondacionit, Statuti i Fondacionit, Akti i Themelimit të Fondacionit, Procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit si dhe komunikimet me e-mail në mes të Paditësve dhe të Paditurave si themelues dhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile”.

Ekzistimi i të drejtës subjektive të Paditësve vërtetohet edhe me faktin se të Paditurat në cilësinë e Kundërshtarëve të sigurimit në kundërshtim të plotë më Statutin e Fondacionit dhe Ligjin për OJQ, duke vepruar në keqbesim, kanë shkelur të drejtat subjektive të Paditësve si themelues dhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Me veprimet e të Paditurave, Paditësit efektivisht janë përjashtuar në mënyrë arbitrare nga Fondacioni dhe organet e tij, përfshirë edhe nga e drejta e tyre për shfrytëzimin e pronës dhe pasurisë së Fondacionit.

B. Ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit pala kundërshtarë do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave ose në mënyrë tjetër do të ndikojë negativisht në të drejtat e Propozuesve të sigurimit

Siç është argumentuar më lartë, të Paditurat/Kundërshtarët e Sigurimit, duke vepruar me keqbesim, në mënyrë arbitrare dhe në kundërshtim të plotë me Statutin e Fondacionit kanë larguar Paditësit nga pozita e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit. Veprimi i tyre me keqbesim është i pakontestueshëm kur merret parasysh se: a) nuk i kanë ftuar fare në mbledhjen e bordit të drejtorëve tre (3) anëtarë të Bordit që e paraqesin shumicën e nevojshme për marrjen e vendimeve për Fondacionin; b) kanë mbajtur mbledhje të kundërligjshme pa a pasur kuorumin për mbajtjen e mbledhjes së Bordit të Drejtorëve; c) në mbledhjen e kundërligjshme kanë emëruar një bord të ri të drejtorëve dhe i kanë përjashtuar nga pjesëmarrja tre (3) anëtarë të bordit të deriatëhershëm; d) e kanë vënë në lajthitje Ministrinë e Administratës Publike, Departamentin për OJQ duke i paraqitur vendimet e kundërligjshme dhe i kanë regjistruar ato në regjistrin e OJQ-ve.

Për shkak të ndryshimeve në Regjistrin e OJQ-ve, bordi i kundërligjshëm me shumicë të votave mund të marrë vendime të obligueshme për Fondacionin. Kjo nga se tre (3) anëtarë të Bordit të Drejtorëve të ri, dy nga të cilët janë të Paditurat, paraqesin shumicën e nevojshme të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për marrjen e vendimeve për dhe në emër të Fondacionit..

Ekziston rreziku real se dy themeluesit e tjerë, përkatësisht të Paditurat Dajana Berisha dhe Jeta Xharra, apo edhe Bordi i paligjshëm i Drejtorëve i emëruar prej tyre, të cilët efektivisht kanë kontrollin mbi Fondacionin, do të ndërmarrin ndonjë veprim apo transaksion me të cilin do të ndryshojnë pronësinë mbi pronën me vlerë prej rreth 1,000,000.00 (një milion) Euro, të blerë nga

Fondacioni. Të dy të Paditurat drejtojnë edhe OJQ të tjera, përkatësisht OJQ Forumi për Iniciativa Qytetare i cili drejtohet nga e Paditura Dajana Berisha, dhe Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) i cili drejtohet nga e Paditura Jeta Xharra. Duke u nisur nga veprimet e shumta në keqbesim e të kundërligjshme të ndërmarra nga të Paditurat, me anë të së cilave i kanë përjashtuar krejtësisht nga Fondacioni tre (3) Paditësit, ekziston rreziku real, se këto dy themeluese do të mund të bartin interesin pronësor mbi pronën e blerë në emër të Fondacionit tek ndonjëra nga këto dy (2) OJQ, apo edhe ndonjë OJQ tjetër. Në këtë rast, duke qenë se ndryshimi i përbërjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit është pranuar nga Departamenti për OJQ pa verifikimin e bazës ligjore për ndryshimin e tillë, çdo transaksion i nënshkruar nga përbërja e re e Bordit të Drejtorëve do të mund të konsiderohej transaksion i vlefshëm, që do të bënte të pamundur realizimin e interesit pronësor mbi pronën e blerë në emër të Fondacionit, po që se e njëjta bartet tek ndonjë person juridik tjetër.

Krahas kësaj, ekziston rreziku real, se pa caktimin e masës së sigurisë së propozuar, të Paditurat dhe Bordi i Drejtorëve jolegjitim i Fondacionit, do të mund të marrin ndonjë Vendim sipas nenit 7 të Statutit të Fondacionit për shpërbërjen e Fondacionit dhe caktimin e ndonjë organizate për përfitimin e pasurisë, përfshi edhe pronën e paluajtshme të blerë në vlerë prej 1,000,000.00 Euro (një milion Euro).

Mos caktimi i masës së sigurisë do të dëmtonte edhe më shumë të drejtat e Paditësve si themelues dhe anëtar të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, për faktin se këta të fundit me veprimet e të Paditurave janë përjashtuar nga pjesëmarrja në qeverisje të Fondacionit dhe nga vendimmarrja në lidhje me politikat dhe çështjet financiare të Fondacionit. Të gjitha vendimet që merren nga Bordi i Drejtorëve jolegjitim pas datës 05 gusht 2019 i bie të merren pa respektuar parimin bazë të vendimmarrjes brenda organizatave të shoqërisë civile, që është parimi i vendimmarrjes demokratike që rrjedh nga neni 20, paragrafi 8 i Ligjit për OJQ-të.

Gjykata, me rastin e vendosjes për masën e sigurisë duhet të ketë parasysh se Fondacioni është pronar i paluajtshmërisë e cila ka vlerë afër 1,000,000.00 (një milion) Euro. Andaj, pa aprovimin e masës së sigurisë, Kundërshtarët e Sigurimit shkelin seriozisht të drejtat e Propozuesve, në cilësinë e tyre si Themelues dhe Anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit, në lidhje me qeverisjen dhe të drejtat e vendimmarrjes në lidhje me pasurinë e Fondacionit.

V. PËRFUNDIMI DHE KËRKESA

Me respekt kërkohet nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm që në bazë të argumenteve provave dhe fakteve të shtjelluara më lartë, dhe për shkak të situatës së vështirë në të cilën ndodhen Paditësit, respektivisht Propozuesit, Propozuesit i propozojnë Gjykatës që menjëherë me rastin e marrjes së kësaj Padie të merr këtë:

AKTVENDIM

- I. **APROVOHET** si i bazuar Propozimi i Propozuesve për Caktimin e Masës së Sigurisë.
- II. **I NDALOHET** Kundërshtarëve të Sigurimit, Përfaqësueses së Autorizuar dhe Bordit të Drejtorëve të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile” që të kryejnë aktivitetet në vijim:
 - Emërimin e zyrtarëve të rinj të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile”;
 - Lidhjen e Kontratave në emër të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile” për tjetërsimin e pasurisë se luajtshme apo të paluajtshme të Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile”;
 - Emërimin e anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile;
 - Marrjen e Vendimit për shpërbërjen e Fondacionit “Shtëpia e Shoqërisë Civile”.


Ndërsa, pas seancës për shqyrtimin kryesor dhe pas shqyrtimit të argumenteve meritore, kërkojmë me respekt nga Gjykata që të merr këtë:

AKTGJYKIM

- I. **APROVOHET** Kërkesëpadia e Paditësve në tërësi si e bazuar.
- II. **KONSTATOHET** se Vendimet e datës 05 gusht 2019, të marra nga të Paditurat Dajana Berisha dhe Jeta Xharra, në kapacitetin e tyre si themeluese dhe anëtare të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, për emërimin e tre anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve, janë marrë në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile dhe Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
- III. **ANULOHEN** Vendimet e datës 05 gusht 2019, të marra nga të Paditurat Dajana Berisha dhe Jeta Xharra, në kapacitetin e tyre si themeluese dhe anëtare të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, për emërimin e tre anëtarëve të rinj të Bordit të Drejtorëve.
- IV. **KONSTATOHET** se Paditësit janë themelues dhe anëtarë të Bordit Drejtues të Fondacionit të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile.
- V. **OBLIGOHET** Departamenti i OJQ-ve që të regjistroj në regjistrin e OJQ-së, Propozuesit Burim Ejupi, Visar Azemi, Astrit Istrefi si themelues dhe anëtarë të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit
- VI. **OBLIGOHEN** të Paditurit që të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe shpenzimet e avokatëve sipas Tarifës së Odës së Avokatëve.

Prishtinë, me datën 15 dhjetor 2020.

Për dhe në emër të Paditësve:



Kushtrim Palushi, Avokat

Fisnik Salihu, Avokat

Shtojca A – Lista e Provave:

1. Autorizimet për përfaqësim;
2. Akti Administrativ me numër Ref. 06-162/2019, i datës 07 nëntor 2019 dhe Akti Administrativ me numër Ref. 06-145/2019, i datës 23 shtator 2019;
3. Certifikata e regjistrimit të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile - CSH, numër 5200400-4;
4. Statuti, Akti i Themelimit dhe Lista e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve;
5. Vendimi për shkarkimin e znj. Dajana Berisha dhe njoftimet e dërguara tek themeluesit e tjerë për këtë vendim së bashku me shkresën e datë 1 Tetor 2019 drejtuar znj. Dajana Berisha;
6. Shkresa e datës 01 tetor 2019, drejtuar z. Bajram Kosumi, Departamenti për OJQ (DOJQ);
7. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 29 Maj 2017;
8. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 13 Shkurt 2019;
9. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 20 Shkurt 2018;
10. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 21 Maj 2018;
11. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 06 Prill 2018;
12. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 30 Qershor 2018;
13. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 05 Gusht 2019;
14. Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 29 Maj 2017;
15. Procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Bordit të Drejtorëve të Fondacionit Shtëpia e Shoqërisë Civile, datë 30 Gusht 2019;
16. Komunikimi (e-mailat) në mes të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve Visar Azemi dhe Burim Ejupi, datë 20 Gusht 2019 dhe 11 Qershor 2019;

17. Kontratë mbi bashkimin e mjeteve për blerjen e banesës në procesin ndërtimor Nr. i LRP-së: 12553/2017, Nr. i REF: 2353/2017, datë 12 Dhjetor 2017, në zyrën e notarisë Sefedin Blakaj;
18. Vendimi nr. Ref. 06-162/2019 të datës 07 nëntor 2019.